

## KONTRATË DHURIMI PJESESH KAPITALI

Sot, më date 11 janar 2022 lidhet kjo Kontratë Dhurimi ndërmjet:

**Znj. Valbona Rezvani**, shtetase shqiptare, lindur në Dukat, Vlorë, më 26.07.1972, mbajtëse e letërnjoftimit me Nr. ID 031550560 dhe Nr. personal H25726047B, madhore, me zotësi të plotë për të vepruar në cilësinë e “Dhuruesit”,

Dhe

**Z. Haxhi Hoxha**, shtetas shqiptar, lindur në Xibër Hane, më 23.06.1968, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. ID034330304 dhe Nr. Personal G80623147H, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar në cilësinë e “Pranuesi i Dhurimit”.

Hyrje:

Në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate Dhurimi, Dhuruesi, I cilizotëron 100% të pjesë vetë kapitalit në shoqërinë “**Energy Consulting**” SHPK, e regjistruar më date 29.06.2021, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me NIPT M11829010H, ka vendosur ti dhurojë Pranuesit të Dhurimit 100% të kapitalit të shoqërisë;

Pranuesi I Dhurimit e pranon dhurimin, miratuar parimisht edhe nga Ortaku I vetëm I shoqërisë.

Për sa më sipër, palët lidhin këtë Kontratë Dhurimi me kushtet e mëposhtme:

### Neni 1 – Objekti

- 1.1 Me anë të kësaj Kontrate Dhurimi, Dhuruesi I transferon me dhurim 100% (njëqind) pjesë kapitali Pranuesit të Dhurimit që e pranon dhurimin.
- 1.2 Transferimi do të kryhet në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqinë Republikën e Shqipërisë.

### Neni 2 – Efektet e Transferimit

- 2.1 Transferimi i pjesëve të kapitalit bëhet pa kundërshpërblim.
- 2.2 Efektet financiare të transferimit fillojnë të përlogariten nga data e regjistrimit të Kontratës së Dhurimit.

### Neni 3 – Deklarime dhe Garanci

- 3.1 Dhuruesi garanton Pranuesin e Dhurimit se pjesët e kapitalit janë të transferueshme dhe të lira nga cdo barrë, hipotekë, apo mjet tjetër për sigurimin e ekzekutimit të detyrimit në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 3.2 Pranuesi I Dhurimit pas transferimit të pjesëve të kapitalit sipas kësaj Kontratë Dhurimi është mbajtësi të të gjitha të drejtave dhe detyrimeve përkatëse, si pjesëmarrja në fitimet e Shoqërisë.

3.3 Pranuesi I Dhurimi tdeklaron se kupton që pjesët e kapitalit janë të lidhura me qenien si ortak në Shoqëri dhe transferimi I tyre tek të tretët I nënshtrohet përcaktimeve në Statutin e Shoqërisë.

#### Neni 4 – Interpretimi I Kontratës

4.1 Kjo kontratë Dhurimi do të interpretohet duke analizuar përmbajtjen e saj në tërësi. Në çdo rast, nëse ndonjë nen ose fjalë është e paqartë, ajo duhet të shikohet në tërësinë e kësaj kontrate dhe në kuadrin e qëllimeve të të dyja palëve për të lidhur këtë Kontratë Dhurimi.

#### Neni 5 – InformacionidheDokumentet

5.1 Informacioni dhe dokumentet në këtë Kontratë Dhurimi janë të vërteta, të përditësuara dhe të plota, deri në këtë datë.

#### Neni 6 – Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

6.1 Mosmarrëveshjet që lindin nga kjo Kontratë Dhurimi do të zgjidhen me mirëkuptim nga palët, në rast të kundërt palët do ti drejtohen Gjykatës kompetente shqiptare.

#### Neni 7 – Të ndryshme

7.1 Kjo Kontratë Dhurimi është hartuar dhe do të interpretohe nëpërputhje me legjislacionin shqiptar.

7.2 Kjo Kontratë Dhurimi është hartuar në 4 (katër) kopje në gjuhën Shqipe, me të njëjtën vlerë ligjore.

#### DHURUESI

Znj. Valbona Rizvani

*Valbona Rizvani*



#### PRANUESI I DHURIMIT

Z. Haxhi Hoxha

*Haxhi Hoxha*

